

ZKM ALBANIA

Notizie dalla Fondazione
NOSTRA SIGNORA
DEL BUON CONSIGLIO,
Tirana



Lajme nga Fondacioni
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË,
Tiranë



9/2024

Redaksia "ZKM ALBANIA" 📍 Kompleksi Spitalor Universitar "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë
📞 unizkm 📧 unizkm 🌐 www.unizkm.al / Per kontakti 📧 pr@fzkm.org

Një Vit i ri Akademik është gati të fillojë

E ARDHMJA JUAJ FILLON NGA ZKM



Prof. Leonardo Palombi
Rektor i UKZKM-së

Të dashur studentë,

Mirë se vini në Universitetin tonë! Dëshiroj t'ju përgëzoj nga zemra ju dhe familjet tuaja për suksesin që keni patur në kalimin e testeve të pranimit dhe në zgjedhjen e institucionit tonë. Po nis një sezon i ri dhe vendimtar i jetës tuaj dhe në emër të stafit pedagogjik dhe të personelit dëshiroj t'ju shpreh të gjithëve angazhimin tonë për t'ju shoqëruar në këto vite shumë të rëndësishme të një formimi jo vetëm profesional, por edhe njerëzor, kulturor, serioz, të thelluar dhe në hapin e kohës. E kam përsëritur shumë herë dhe po e bëj edhe sot me ju: nuk ofrojmë thjesht tituj, por formim! Për këtë arsye do ta gjeni veten në një komunitet ndërkombëtar dhe kozmopolit, gjithëpërfshirës dhe të ngushtë, por edhe kërkues dhe ambicioz për zhvillimin tuaj njerëzor dhe kulturor. Dua të nënvizoj bazuar edhe në atë që ka thënë Papa Gjon Pali II: "Merrni jetën tuaj dhe bëjeni një kryevepër!" Pra, jeta juaj të bëhet kryevepër e inteligjencës, e aftësive, e kulturës dhe e njerëzimit! Angazhim të mbarë! Ne do të jemi këtu dhe unë do të jem gjithmonë pranë jush. Dyert e mia dhe tonat janë të hapura për çdonjërin nga ju.

Salla të reja për studentë të rinj (dhe të shumtë)

SALLA, PISHINË REHABILITIMI, LABORATORË FARMACEUTIKË

Gjatë verë, aktiviteti i UniZKM nuk u ndal kurrë: nga njëra anë duke ndjekur procedurat e regjistrimit të kandidatëve të rinj, nga ana tjetër duke përgatitur sallat e reja për të akomoduar një numër studentësh gjithmonë në rritje. Gjithashtu dy laboratorë të rinj janë bërë gati për Programin e Studimit të Farmacisë veçanërisht për prodhimin galenik. Së fundmi, edhe pishina rehabilituese (e vetmja në Shqipëri dhe funksionale prej pesëmbëdhjetë vjetësh) është rinovuar për ta bërë atë më të sigurt dhe më mikpritëse.



Studentë të rinj në kërkim të mundësive


NJE VERË PLOTË ME EMOCIONE

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" priti edhe këtë vit qindra maturantë nga e gjithë Shqipëria, të cilët u bënë pjesë e procesit të regjistrimit përfundimtar pranë UKZKM-së për vitin e ri akademik. Pas një periudhe të gjatë përgatitjeje dhe njohjeje me programet tona dhe Kampusin Universitar maturantët zgjedhën programet e studimit, duke hyrë kështu në një fazë të re dhe vendimtare të jetës së tyre. Punonjësit e Zyrës së Pranimeve dhe ata të sekretarive mësimore dhanë ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme për të rinjtë që tashmë janë pjesë e historisë së re akademike të Universitetit Katolik.



Një rrugëtim i ri fillon për maturantët dhe familjet e tyre, të cilët i kanë besuar edukimin dhe të ardhmen profesionale të fëmijëve të tyre standardeve evropiane të UKZKM-së.

22 shtator: kujtimi i të lumit Luigji Monti



FORCA SHPIRTËRORE E TË VARFËRVE

Të dielën e 22 shtatorit Kisha Katolike kujton figurën e të Lumit Luigji Monti. Ai ka qenë infermier dhe edukator i shekullit të nëntëmbëdhjetë, i quajtur "Atë" për forcën gjeneruese që u transmetonte të sëmurëve dhe jetimëve. Këtë vit ne festojmë dyqindvjetorin e lindjes së Atë Montit, i cili nuk ishte prift dhe duke e jetuar në mënyrë rigorozë Ungjillin, tërhoqi drejt vetes të rinj dhe të rritur të gjallëruar nga një besim bujar. Fondacioni ZKM frymëzohet prej tij dhe gjen tek ai burimin e veprimtarisë në Shqipëri. Në Tiranë, kujtimi i tij njihet përmes klinikës në Rugën e Kavajës, vepra e parë e krijuar në Shqipëri pas ardhjes së "vëllezërve" të tij në vitin 1993.

Të premten e datës **20 shtator 2024** në orën **12:00** do të kremtohet në "Aula Magna" **Mesha e Shenjtë e të Lumit Luigi Monti**, e cila drejtohet nga **Imzot. Simon Kulli**, ipeshkv i Sapës.

Papa Françesku dhjetë vjet më vonë

NJË VIZITË QË NUK E HARROJMË



Udhëtimi i parë i Papa Françeskut jashtë Vatikanit sapo mori detyrën ishte në Shqipëri, pikërisht dhjetë vjet më parë (21 shtator 2014). Kjo zgjedhje nuk ishte e rastësishme dhe i dha menjëherë një karakter të veçantë papatit të ri. I pritur nga presidenti i Fondacionit ZKM, nga Atë Daniele Bertoldi, Papa Françesku u takua në ambientet e Universitetit me përfaqësues të komuniteteve të ndryshme fetare të pranishëm në Shqipëri. Ngjarja la një përshtypje të fortë dhe nderoi përgjithmonë Fondacionin tonë. Në oborrin e Universitetit Katolik është vendosur një pllakatë mermeri për të përkujtuar vizitën e Shenjtërisë së tij.

NËNË TEREZA

NJË BUZËQESHJE ËSHTË FILLIMI I ÇDO DASHURIE



Këtë vit kujtojmë 114 vjetorin e lindjes së Nënë Terezës, shenjtore shqiptare. Nënë Tereza u vendos në Kalkuta (Indi) para Luftës së Dytë Botërore. Ajo u bë mësuese dhe shpejt u bë drejtoreshë e një shkolle vajzash. Urdhri fetar që ajo krijoi në vitin 1951 mori emrin "Misionarët e Bamirësisë" për t'u shërbyer të varfërve dhe të dëshpëruarve në Kalkutë, në Indi dhe në botë. Në vitin 1979 mori Çmimin Nobel për Paqen dhe për herë të parë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Në shtator të vitit 2016, Papa Françesku e shpalli Nënë Terezën Shenjtore, duke njohur kontributin e saj në shërbim të njerëzimit dhe në shpalljen e mesazhit të krishterë.

20

VITE ANGAZHIM DHE ZHVILLIM

UNIVERSITETI KATOLIK I TIRANËS, NJË PJESË E EVROPËS NË SHQIPËRI

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" feston këtë vit 20 vjetorin e themelimit. Ky është një moment i rëndësishëm jo vetëm për Fondacionin "Zoja e Këshillit të Mirë", i cili ka pasur dhe ka si mision parësor shëndetin e njerëzve dhe edukimin e të rinjve, por edhe për Shqipërinë që në këto 20 vite ka gëzuar standardet më të mira akademike të vendosura nga UKZKM.

Në këto 20 vite, Universiteti Katolik ka sjellë dëshmi të qarta dhe reale, përmes qindra të diplomuarve tanë, të cilët tashmë janë histori suksesi kudo që punojnë, në Shqipëri apo në Vende të ndryshme të Bashkimit Evropian e më gjerë. Falë cilësisë së lartë të mësimdhënies, nivelit të lartë profesional të profesorëve tanë, kërkimit të vazhdueshëm shkencor dhe standardeve evropiane që ofron Kampusi ynë Universitar, të gjithë të diplomuarit e UKZKM-së punësohen menjëherë, deri në 96% në Shqipëri dhe në vendet e BE-së, sapo marrin diplomën e UKZKM-së.

Studentët besojnë te programet e studimit që ofron Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", pasi i gjithë stafi akademik dhe mbështetës i UKZKM-së është çdo ditë krahu tyre, sepse suksesi i këtyre të rinjve është prova e asaj çfarë kemi bërë këto 20 vjet.



Programi i virologjisë në UniZKM

KOVIDI KRIJOI NJË MODEL

Vitet e fundit programi i mikrobiologjisë së përgjithshme në Fakultetin e Farmacisë ka shtuar volumin e njohurive virologjike për shkak të shfaqjes dhe përhapjes të sëmundjeve të transmetuara në nivel pandemie. Sëmundjet infektive që mund të transmetohen edhe nga kafshët ishte një nga shkaqet e pandemisë së fundit të koronavirusit (Covid-19). Në mënyrë të ngjashme janë zhvilluar dhe përhapur ndër shekuj epidemitë e transmetuara nga gjallesat tek njeriu. Insektet dhe artropodët kanë gjetur habitatin e tyre ideal me rritjen e temperaturës mesatare edhe në rajonet e buta. Edhe viruset që mendoheshin të zhdukur janë rishfaqur, si p.sh, virusi i lisë së majmunit. Në vitin e ardhshëm akademik Programi i Mikrobiologjisë në UniZKM do të sjellë Programin e Virologjisë së Përgjithshme dhe Molekulare ku do të trajtohen karakteristikat e viruseve, veçanërisht atyre patogjene për kafshët dhe njerëzit. Cikli i tyre replikativ, mekanizmat e transmetimit dhe metodat e diagnostikimit molekular që përdoren aktualisht do të jenë pjesë e diskutimit në vitin e ri akademik.



Gjithashtu gjatë leksioneve do të tregohet edhe për studimet e fundit mbi të cilat u ndërtuan terapitë në trajtimin e sëmundjeve gjenetike. Një shembull i tillë është prodhimi i vaksinave. Programi do të zhvillohet nga Prof. Antonia Radaelli, e cila ka zhvilluar të njëjtën lëndë për shumë vite në Fakultetin e Farmacisë të Universitetit të Milanos. Profesoresha do të kryejë praktikë mësimore edhe në laboratorin e ri të NATO-s të Virologjisë molekulare ngritur në UniZKM.

Qendra jonë universitare e gjuhëve

GJUHËT E HUAJA SI PASAPORTË KULTURE



Prej vitit 2014 në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” operon me sukses Qendra Universitare e Gjuhëve të huaja. Kjo qendër organizon kurse gjuhe dhe kulturen në italisht, anglisht, gjermanisht dhe shqip. Në përfundim të kurseve të dedikuara qendra lëshon Certifikatën Ndërkombëtare TELC për njohjen e gjuhës gjermane dhe Certifikatën Ndërkombëtare PLIDA për njohjen e gjuhës italiane.

Qendra ofron konsulencë të vazhdueshme krahas orëve mësimore të përcaktuara, duke u dhënë mundësinë të interesuarve të mësojnë një gjuhë të huaj në të gjitha dimensionet e saj.



Qendra jonë është pjesë e një rrjeti të madh bashkëpunëtorësh dhe partnerësh ndërkombëtarë, si Universiteti Katolik i “Sacro Cuore” i Milanos, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Universiteti i Parmës, Organizmi i certifikimit ndërkombëtar TELC dhe Organizmi i certifikimit ndërkombëtar ‘PLIDA.

Personazh ZKM

ELIDA MAUGERI

Njihuni me Zonjën Elida Maugeri, e cila është një nga bashkëpunëtoret e para të Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë”. Elida nisi të punojë pranë FZKM në korrik të vitit 1995 dhe që prej asaj kohe është pjesë e rrugëtimit të këtij institucioni të rëndësishëm në Shqipëri. “Jam dëshmitare e lindjes dhe rritjes së fondacionit, -tregon Elida-, dëshmitare e një ëndrrë që u bë realitet. E kam parë shndërrimin e një projekti fillimisht të vogël që u kthye në një projekt gjigand e të mrekullueshëm, duke ndjekur me krenari sesi sfidat dhe vendimet e mëdha i shërbejnë historisë së zhvillimit dhe edukimit. Puna në FZKM më ka motivuar gjithmonë, duke u bërë shtysë për të dhënë më të mirën time”, tregon mes të tjerave Elida, ndërsa edhe kur flasim me të, është mes shkresave duke punuar. Duke njohur kontributin e Fondacionit “Zoja e Këshillit të Mirë”, Elida tregon se misioni i çuar përpara nga FZKM është një mesazh domethënës që ka ndikuar e vazhdon të ndikojë direkt në rritjen e saj profesionale e njerëzore. Tashmë janë bërë plot 29 vite në punën e saj dhe për Elidën ky është një aset që ajo me krenari thotë se i përket. Duke buzëqeshur ajo tregon se ndihet e vlerësuar, e përkrahur, e respektuar, dhe se ndihet si në shtëpi. Kur kthehet pas në kohë kujton se në fillimet e Fondacionit ishin vetëm 6 punonjës. Sot pas 29 vitesh janë me qindra kolegë të rinj që me dëshirat dhe pasionet e tyre për punën i kanë shtuar vlerë FZKM-së dhe i japin energji pozitive këtij realiteti.



Elida mban detyrën e Përgjegjëses së Zyrës së Financës dhe detyrën e Administratores së Farmacisë IDIAL. “Ka qenë fat dhe eksperiencia më e bukur e jetës, dhe një ngjarje që kushdo do t’a kishte zili”, rrëfen Elida për buletin tonë.

Një aktivitet formimi

SUMMER SCHOOL NJË MUNDËSI PËR STUDENTËT



Kemi kënaqësinë të komunikojmë mbylljen me sukses edhe këtë vit të "Summer School 2024", me temë "Roots of War & Establishment of a Lasting Peace". Edicionin e 9-të të kësaj shkolle verore e ndoqën një grup studentësh, të cilët u njohën me traditën e pasur të Shkencave të Paqes.



Kurrikula përfshiu лекsione mbi ekonominë, shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe historinë. Leksionet iu drejtuan studentëve e të diplomuarve, të cilët treguan interes të lartë në njohjen shkencore të temës së paqes. Gjatë ditëve të "Shkollës Verore" në UniZKM lektorët u dhanë studentëve një panoramë mbi studimet e avancuara të kësaj fushe që lidhet ngushtë me marrëdhëniet ndërkombëtare.

Aventura që ndërtojmë së bashku

STUDENTË TË RINJ: MIRË SE ERDHËT!

Urojmë mirëseardhjen të rinjve që nisin eksoerencën e tyre akademike në 20-vjetorin e themelimit të Universitetit tonë. Në këto dy dekada e kemi çuar Shqipërinë në Evropë falë programeve të studimit të njohura plotësisht në Bashkimin Evropian, por edhe e kundërta është e vërtetë: kemi sjellë Evropën në Shqipëri përmes qindra studentëve që kanë zgjedhur të vijnë këtu dhe katërqind pedagogëve për mësimdhënie.



Universiteti Katolik është një hapësirë akademike, kulturore që studentët do ta ndajnë bashkë. UniZKM do t' i mbështesë ata për të arritur një formim të plotë. Të rinjtë hyjnë me entuziazëm në këtë rrugëtim dhe mund të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ofron Universiteti ynë.

HAPJA e **200-VJETORIT** të **LINDJES** së të **LUMIT** **LUIGJI MONTI** në **SHQIPËRI** (1825-2025)



E premte **20 Shtator 2024**
Universiteti Katolik ZKM, Tiranë

Ora 12:00

MESHA E SHENJTË E TË LUMIT LUIGJI MONTI, themeluesi ynë

Udhëhequr nga:

Mons. SIMON KULLI

Ipeshkvi i Sapës, Zv.president i Konferencës Ipeshkvore shqiptare dhe i deleguar për baritoren shëndetësore



Fondacioni
Zoja e Këshillit të Mirë
Tiranë

Përkushtuar edukimit, përkushtuar shëndetit

Fr. Ruggero Valentini
President, Fondacioni ZKM



Kongregata
e Bijve të Zojës
së Papëlyer
Tiranë

P. Binu Peedyieckal
Përgjegjës i Komunitetit CFIC



UNIVERSITETI KATOLIK
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

PËRZGJIDH
UNIVERSITETI KATOLIK
"ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

PORTALI U-ALBANIA
19-21 SHTATOR 2024

RAUNDI i II-të

ARKITEKTURË

EKONOMI

FARMACI

MJEKËSI

ODONTOIATRI
DHE PROTEZA DENTARE

INFERMIERI

FIZIOTERAPI

+355 42 273 290 info@unizkm.al

www.unizkm.al

Seduta di Laurea in Architettura

📅 23 settembre 2024

🕒 09:30

📍 Aula Magna



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

www.unizkm.al

Regjistrohu në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" **28 Shtator - 7 Tetor 2024**